

Zgjerimi Rajonal dhe i Qëndrueshëm i Grupit të shitjes me pakicë Schwarz

Vendi:
Rajonal

Nr Projekti:
53644

Sektori i Biznesit:
Agrobiznes

Lloji i Njoftimit:
Privat

Kategoria Mjedisore:
B

Data e Aprovimit:
20 Korrik 2022

Statusi:
Në pritje të aprovimit, rishikimi final i përfunduar

Publikimi i dokumentit në gjuhën angleze:
16 Qershor 2022

Përshkrimi i Projektit

Sigurimi i një huaje prej 175 milionë euro për Grupin gjerman të shitjes me pakicë Schwarz Group (Schwarz, ose Grupi). Fondet e huasë do të përdoren për të mbështetur zgjerimin e dyqaneve Lidl në Ballkanin Perëndimor përfshirë Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi (75 milionë euro) dhe zgjerimin e aktiviteteve të Kaufland në Rumani dhe Moldavi (100 milionë euro).

Objektivat e Projektit

Huaja do të përdoret për të mbështetur programin e investimeve 2022-2024 të Grupit, duke u përqëndruar në zhvillimin e dyqaneve Kaufland në Rumani dhe Moldavi dhe Lidl në Ballkanin Perëndimor.

Impakti i tranzicionit

Vlerësimi ETI: 61

Impakti i tranzicionit do të jetë si pasojë e:

Gjithë-përfshirjes (parësor): Kaufland Rumani dhe Moldavi do të promovojnë politika gjithë-përfshirëse dhe gjinore të burimeve njerëzore nga të cilat do të përfitojnë refugjatët dhe punonjësit ekzistues, vecanërisht nënat dhe prindërit. Kompania në partneritet me organizatat e shoqërisë civile do të ofrojë përkujdesje ndaj fëmijëve si dhe agjencitë lokale të rekrutimit do të ofrojnë mundësi punësimi për refugjatët nga Ukraina. Kompania do të prezantojë gjithashtu menaxhimin e diversitetit dhe trainime për stafin dhe do të adoptojë një qasje të shkëmbimit të praktikave më të mira në sektorin privat duke ndarë eksperiencat e UNHCR Global Compact për refugjatët.

I gjelbër Green (sekondar): ndërtimi i dyqaneve të reja me efikasitet të lartë energjie në përputhje me standartet ndërkombëtare të ndërtimeve të gjelbra EDGE në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Informacion për Klientin

LIDL STIFTUNG AND CO. KG

Stiftsbergstrasse 1, 74167 Neckarsulm, Germany

KAUFLAND ROMANIA S.C.S

Barbu Vacarescu nr. 120-144, 020284 Bucuresti, Sector 2, Romania, të dy 100% degë të Grupit

Financimi i BERZH

EUR 175,000,000.00

Kosto Totale e Projektit

EUR 850,000,000.00

Vlera e Shtuar

Vlera e shtuar nga investimi i Bankës dallohet në mbështetjen që jepet në vendosjen e standarteve të larta të gjithëpërfshirjes në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile vecanërisht në raport me punësimin e refugjatëve dhe mbështetjen në përkujdesjen ndaj fëmijëve. BERZH do të ofrojë eksperiencën e saj në mirëqeverisjen e korporatave në kuadër të ndryshimeve klimatike duke mbështetur nismën e Grupit për de-karbonizimin e zinxhirit të vlerës.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar B (ESP 2019). Impakti mjedisor dhe social i lidhur me ndërtimin dhe aktivitetin e dyqaneve në shtatë vende është identifikuar dhe janë marrë masat për menaxhimin e tij. Vlerësimi mjedisor dhe social është bërë bazuar në informacionet e dhëna nga Grupi Schwarz, nga vizitat në një nga pikat e shitjes në Bukuresht për Rumaninë (përfshirë intervista me menaxherë dhe punonjës), pyetësorë për projektin në 5 vendet (Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri, Kosovë dhe Malin e Zi) nga vlerësimet e mëparshme dhe rezultatet e monitorimeve në Moldavi. Vlerësimet e hershme dhe më të fundit në Greqi dhe Moldavi kanë treguar se ekzistojnë kapacitetet dhe sistemet e Lidl dhe Kaufland për të menaxhuar çështjet mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë në punë në zhvillimin dhe operimin e dyqaneve, magazinave dhe logjistikës në përputhje me Kriteret e Bankës. Sidoqoftë disa kërkesa që lidhen me kushtet e punës, eficientësinë e energjisë dhe mbikqyrjen e kontraktorëve do të duhet të zbatohen dhe të përfshihen në planin e masave mjedisore dhe sociale, i cili është hartuar dhe do të miratohet përpara mbledhjes së Bordit.

Midis shtatë vendeve që mbulohen nga ky transaksion i ri, vetëm Rumania dhe Moldavia kanë dyqane ekzistuese të cilat si rrjedhojë janë bërë subjekt i një vlerësimi më të detajuar Mjedisor dhe Social vecanërisht në kuadër të menaxhimit të punës dhe kontraktorëve. Kaufland Rumani organizon një pyetësor anonim për punonjësit çdo vit. Mekanizmi për Ankesat është gjithashtu funksional. Kaufland Rumani ka marrë për vitin e shtatë rradhazi certifikimin Top Employer në Rumani. Kompania ka krijuar vende pune për refugjatët ukrainas gjatë 2022, vecanërisht për ata që duan të qëndrojnë në Rumani për një periudhë afatmesme ose afatgjatë. Është krijuar një call center që i lejon refugjatët të aplikojnë dhe kontrata tip e punës është përkthyer në gjuhën ukrainase. Vizita në dyqanin në Bukuresht dëshmon se kushtet e punës janë të përshtatshme dhe punonjësit janë përgjithësisht të kënaqur. Objektivat mjedisore afatmesme dhe afat shkurtra janë të përcaktuara. Kaufland ka punësuar një konsulent të jashtëm për të zhvilluar auditime periodike (4 herë në vit) për shëndetin dhe sigurinë në punë në secilin dyqan në Rumani. Mekanizmi i ankesave dhe regjistri i tyre janë krijuar (i njëjti mekanizëm). Raporti i qëndrueshmërisë për Kaufland Rumani publikohet çdo vit.

Kaufland Moldavia është i angazhuar (sic parashikohet në planin e masave mjedisore dhe sociale) të organizojë një sondazh anonim për punonjësit çdo vit (i pari u krye në fund të vitit 2021) dhe është në proces të organizimit të zgjedhjes së përfaqësuesve të punonjësve dhe negociimit të kontratave kolektive (në fund të 2022). Mekanizmi për ankesat për punonjësit është krijuar në 2020. Raporti i Parë i Qëndrueshmërisë për Kaufland Moldavi u publikua në Shkurt 2022. Gjashtë dyqanet e para të hapura kanë marrë certifikimin ISO50001. Kontrolli i 2021 tregoi se ka një zbatim të kënaqshëm të planit të masave mjedisore dhe sociale në Moldavi.

Në të shtatë vendet, procesi i blerjes së trullit është i ngjashëm. Truallet për dyqanet e reja janë blerë nga zhvilluesit të cilët janë përgjegjës që trulli i ofruar të jetë pa detyrime ligjore (përfshirë trashëgimi mjedisore). Klienti konfirmon se toka është blerë mbi bazën e vullnetit të lirë shitës /blerës. Leja e ndërtimit merret nga zhvilluesi. Detyrimi për të marrë lejet e nevojshme është i parashikuar në para-kontratën e blerjes. Kaufland/Lidl kërkojnë që çdo kontraktor të nënshkruajë Kodin e Normave për Partnerët e Biznesit i cili përfshin jo-diskriminim, punën e detyruar dhe punën e

fëmijëve, të drejtën e shoqatave, pagave dhe orëve jashtë orarit, sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjatë punimeve Kaufland dhe Lidl do të punësojnë kompani të specializuara në shëndetin dhe sigurinë në punë për të monitoruar punimet. Sistemet e menaxhimit mjedisor të Kaufland/Lidl dhe burimet e efikasitetit janë të mirë integruara në aktivitetet kryesore si ndërtimi dhe planimetria e dyqaneve dhe në përputhje me KP3. Të gjithë dyqanet janë ndërtuar pa asnjë element asbesti. Synimi është që secili nga dyqanet e reja të marrë certifikimin ISO50001.

Monitorimi mjedisor dhe social i Bankës do të vazhdojë të mbështetet kryesisht në raportimet vjetore duke mbajtur mundësinë e vizitave monitoruese nëse nevojitet. Projekti është në përputhje me masat për parandalimin e ndryshimeve klimatike sic paraqitet në listën e përbashkët të Bankave Zhvillimore Shumëpalëshe. Duke konsideruar vendndodhjet e shumëfishta të dyqaneve Projekti nuk është vecanërisht i ekspozuar ndaj risqeve klimatike fizike dhe është në përputhje me marrëveshjen e Parisit. Treguesi për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër (GET) është 100 %.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grant

Nuk ka.

Informacion për kontaktin e kompanisë

Schwarz Dienstleistung KG
Finanzen Stiftsbergstr. 1 74172 Neckarsulm Germany

Data e përditësimit të fundit të Dokumentit Përmbledhës

28 Qershor 2022

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH:](#)

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.